REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
SEKTORI I TAKSAVE DHE TARIFAVE

Sektori i Taksave dhe Tarifave ushtron këto funksione kryesore:

- Evidentimin, regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave për subjektet dhe familjet që kanë detyrime fiskale vendore;
- Administrimin e taksave dhe tarifave vendore sipas dispozitave ligjore dhe paketës fiskale në fuqi;
- Llogaritjen, faturimin dhe ndjekjen e arkëtimit të detyrimeve vendore;
- Administrimin e debive dhe kamatvonesave për subjektet debitore;
- Kryerjen e verifikimeve dhe kontrolleve në terren për evidentimin e aktiviteteve ekonomike dhe sipërfaqeve të tatueshme;
- Hartimin e raporteve periodike mbi realizimin e të ardhurave vendore;
- Bashkëpunimin me strukturat e tjera të bashkisë dhe institucionet shtetërore për shkëmbimin e informacionit dhe administrimin fiskal;
- Informimin dhe asistimin e qytetarëve dhe bizneseve lidhur me detyrimet fiskale dhe procedurat administrative;
- Përgatitjen e materialeve dhe të dhënave për hartimin e paketës fiskale vjetore;
- Ndjekjen e procedurave administrative për subjektet debitore në përputhje me legjislacionin në fuqi.